

# FORMULARI I ANKESËS PRANË AUTORITETIT/ENTIT KONTRAKTOR DHE KOMISIONIT TË PROKURIMIT PUBLIK

Ankesë drejtuar: Autoriteti/Entit Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik

## Seksioni I. Identifikimi i ankimuesit

Ankimuesi mund të jetë një ofertues ose ofertues i mundshëm (p.sh. individ, operator ekonomik, shoqatë, bashkim operatorësh ekonomikë)

LLUCA

Emri i plotë i ankimuesit (ju lutem shtypeni)

K29824105N

NUIS/NIPT

Ndertesa prane kantierit te prodhimit te materialeve inerte.

Adresa

Peqin

Albania

3501

Qyteti

Shteti

Kodi Postar/Posta

0684276844

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

llucashpkpeqin@gmail.com

E-mail

administrator ligjor Naim Lluca

Emri dhe titulli i zyrtarit të autorizuar për lëshimin e ankesës (ju lutemi shkruani)

2024/05/20

Nënshkrimi i zyrtarit të autorizuar

Data (viti/muaji/dita)

0684276844

Numri i telefonit (përfshirë kodin e zonës)

Numri i faksit (përfshirë kodin e zonës)

## Seksioni II: Informacion mbi procedurën

Numri i referencës së procedurës/Lotit

*Plotësoni numrin e referencës së kontratës në njoftimin e kontratës ose në dokumentin e tenderit.*

REF-04512-05-13-2024

---

Tipi i procedurës për ankesën

Procedure Prokurimi Publik

Tipi i ankesës

Dokumenta Tenderi

---

Plotësoni llojin e procedurës së përdorur

Open Local

---

Autoriteti/Enti Kontraktor

*Emri i autoritetit/entit kontraktor që administrojnë procesin e prokurimit.*

Bashkia Has

---

Vlera e përlogaritur e prokurimit

*Vlera e përlogaritur e kontratës/Marrëveshjes Kuadër (shuma në shifra dhe fjalë)*

97431542

---

Objekti i kontratës/Marrëveshjes Kuadër

*Përshkrimi i shkurtër i punëve/mallrave/shërbimeve objekt kontrate/marrëveshje kuadër.*

“Rikonstruksion i Gjimnazit Skenderbeu , Has”.

---

Afati i fundit për paraqitjen e ofertës

*Data (viti/muaji/dita)*

2024/05/30

---

Data e publikimit të Njoftimit të Fituesit

(Data (viti/muaji/dita) nëse është e zbatueshme)

---

Data e nënshkrimit të kontratës

(Data (viti/muaji/dita) në rastet e kërkesave për pavlefshmërinë e kontratës)

---

Tipi i kontratës

Data e zhvillimit të procedurës

Punë

2024/05/30

---

Numri i njoftimit

Kodi CPV

CN/72241/05132024

45214200-2

---

Ankese mbi argument në KPP

---

### Seksioni III: Përshkrimi i ankesës

#### 1. Baza ligjore

(Shkelje/arsyetime ligjore, bazuar në vendime, akte, dokumente, etj.)

Ligji nr.162/2020 “Per prokurimin publik” ,VKM nr.285 date 19.5.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, vkm nr.42 date 16.1.2008 per licencat ne sektorin e ndertimit

---

#### 2. Objekti i ankesës

- Modifikim i dokumentave të tenderit

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës tuaj.

(Citoni këtu arsyet e skualifikimit)

- Kundërshtim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me kualifikimin e ofertës të një/disa operatori/ëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

(Citoni operatorin/ët ekonomik për të cilin keni pretendime)

- Pavlefshmëri kontrate

(Citoni kontratën për të cilën kërkoni pavlefshmërinë)

- Tjetër

*(Citoni këtu objektin e ankesës që nuk përfshihet më sipër)*

### **3. Rrethanat dhe faktet** □

*Përshkruani rrethanat e faktit.* □

Ne sistemin e prokurimit elektronik me date 14/04/2024 është publikuar zhvillimi i procedurës së prokurimit të hapur me objekt ” “Rikonstruksion i Gjinnazit Skenderbeu , Has”. me nr. REF-04512-05-13-2024 reference . Duke analizuar në teresi kriteret e kualifikimit në dokumentat e tenderit kemi konkluduar se ato janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik si dhe të akteve të tjera nenligjore në zbatim . Nisur nga ky fakt me ane të kësaj ankese kundërshtohen dhe kërkohet modifikimi/heqja e kriterëve të kualifikimit të parashikuara në dokumentat standarte të tenderit.

### **4. Argumentime mbi shkeljet e pretenduara**

*Përshkruani në mënyrë koncize shkeljet e pretenduara, duke argumentuar qartë dhe saktë se përse pretendoni për paligjshmëri në veprimet e autoritetit/entit kontraktor.*

Konkretisht kërkohet të modifikohen/hiqen kriteret e kualifikimit si më poshtë :

1.Pika 2.3.2 e kriterëve të veçanta të kualifikimit kërkon që operatori ekonomik duhet të disponojë licencë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim bazuar në VKM nr.42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dënis së licencave profesionale të zbatimit ,klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi” , i ndryshuar . Nga ana e autoritetit kontraktor janë kërkuar diponimi i kategorive të licencës dhe klasifikimit të tyre në kundërshtim me ligjin në fuqi .Duke i rradhitur si më poshtë kategoritë e licencave dhe klasifikimet e tyre që kundërshtohen bazuar në analiza ligjore të kategorive të licencave të kërkuara në po i kundërshtojmë duke kërkuar modifikimin/heqjen e tyre pikat e mëposhtme .

Kundërshtohen kategoritë punimeve të përgjithshme të ndërtimit dhe kërkohet modifikimi/heqja e tyre si më poshtë :

-Kategoria NP-1 Punime germimi në toke klasifikimi B

Ky kriter kualifikimi është vendosur në kundërshtim me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dënis së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, që sanksionon që kategoria NP-1 klasifikimi B kërkohet për kryerjen e punimeve të germimit në toke me vlerë nga 21-50 milione leke .

Në rastin konkret dhe bazuar projektin e zbatimit ,në preventivin e punimeve dhe relacionin teknik , nuk rezultojnë të këtu asnjë ze punimesh germimi në toke me vlerë nga 21-50 milione leke në mënyrë që të vendoset kategoria NP- 1 klasifikimi B e licencës së punimeve të zbatimit në ndërtim .

Nisur nga sa përshkruam më sipër kërkojmë që ky kriter të modifikohet dhe të bëhet NP-1 klasifikimi A .

#### -Kategoria NP-2 Ndertime civile dhe industriale klasifikimi C

Ky kriter kualifikimi eshte vendosur ne kundershkrim me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, qe sanksionon qe pika NP-2 klasifikimi C kerkohet per kryerjen e punimeve te ndertimeve civile dhe industriale me vlere nga 51-100 milione leke .

Ne rastin konkret ,nisur nga lloji i punimeve qe do te kryhen dhe bazuar ne preventivin e punimeve,projektin e zbatimit dhe relacionin Teknik nuk rezulton te kete asnje ze punimesh ndertimi civile dhe industriale me vlere nga 11-100 milione leke ne menyre qe te vendoset pika NP- 2 klasifikimi C e licences se punimeve te zbatimit ne ndertim .

Nisur nga sa pershkruam me siper kerkojme qe ky kriter te modifikohet dhe te behet NP-2 klasifikimi A .

#### -Kategoria NP-7 klasifikimi B

Ky kriter kualifikimi eshte vendosur ne kundershkrim me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, qe sanksionon qe pika NP- 7 klasifikimi B kerkohet per kryerjen e punimeve per ujesjelles ,kanalizime ,vepra kullimi e vaditje , me vlere nga 21-50 milione leke .

Ne rastin konkret ,nisur nga lloji i punimeve qe do te kryhen dhe bazuar ne preventivin e punimeve,projektin e zbatimit dhe relacionin Teknik nuk rezulton te kete asnje ze punimesh ujesjelles ,kanalizime ,vepra kullimi e vaditje me vlere nga 21-50 milione leke ne menyre qe te vendoset kategoria NP- 2 klasifikimi C e licences se punimeve te zbatimit ne ndertim .

Nisur nga sa pershkruam me siper kerkojme qe ky kriter te modifikohet dhe te behet NP-7 klasifikimi A .

Kundershtohen kategoritee punimeve speciale te ndertimit dhe kerkohet modifikimi/heqja e tyre si me poshte :

#### -Kategoria NS-8 klasifikimi B

Ky kriter kualifikimi eshte vendosur ne kundershkrim me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, qe sanksionon qe pika NS-8 klasifikimi B kerkohet per kryerjen e punimeve per ndertime parafabrikat beton arme ,struktura metalike dhe druri , me vlere nga 21-50 milione leke .

Ne rastin konkret ,nisur nga lloji i punimeve qe do te kryhen dhe bazuar ne preventivin e punimeve ,projektin e zbatimit dhe relacionin Teknik nuk rezulton te kete asnje ze punimesh per kryerjen e ndertimeve parafabrikat beton arme ,struktura metalike dhe druri me vlere nga 21-50 milione leke ne menyre qe te vendoset kategoria NS 8- 2 klasifikimi B e licences se punimeve te zbatimit ne ndertim .

Nisur nga sa pershkruam me siper kerkojme qe ky kriter te modifikohet dhe te behet NS-8 klasifikimi A .

#### -Kategoria NS-9 klasifikimi B

Kategoria NS-9 Punime strukturore speciale referuar VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve, qe ushtrojne veprimtari ndertimi”, perkufizohet si me poshte :

Punime strukturore speciale Konsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetim ngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave, të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistente dhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëve të çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotë ose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përfshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratoriale nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.

Ne rastin konkret referuar projektit të zbatimit preventiv të punimeve si dhe relacionit Teknik nuk rezulton të jetë parashikuar asnjë ze punimesh që përfshihet në punimet strukturore speciale dhe për këtë arsye kërkojmë heqjen e këtij kriteri kualifikimi.

-Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike klasifikimi B

Ky kriter kualifikimi është vendosur në kundërshtim me VKM nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhenies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", që sanksionon që pika NS -18 klasifikimi B kërkohej për kryerjen e punimeve topogjeodezike me vlerë nga 21-50 milione leke. Në rastin konkret dhe bazuar në preventivin e punimeve nuk rezulton të ketë asnjë ze punimesh topogjeodezike me vlerë nga 21-50 milione leke në mënyrë që të vendoset pika NS 18 B e licencave punimeve të zbatimit në ndërtim.

Nisur nga sa përshkruam më sipër kërkojmë që ky kriter të modifikohet dhe të bëhet NS-18 klasifikimi A.

2.Pika 2.3.3 Disponimin për periudhën e 3 muajve të fundit të një numri prej 100 punonjësish

Ky kriter kualifikimi kërkon që operatori ekonomik të disponojë në listepagese për periudhën e 3 muajve të fundit një numër prej 100 (njëqind) punonjësish.

Ky kriter jo vetëm që është diskriminues dhe kufizues konkurrence por është dhe i paargumentuar nga ana e autoritetit kontraktor. Nga një mbledhje aritmetike kërkesave për staf të kualifikuar dhe mbështetës të bërë nga ana e autoritetit kontraktor në dokumentat standarte të tenderit konkludohet që numri i punonjësve i nevojshëm për realizimin e punimeve është 41 (dyzet e një) punonjës. Autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar në asnjë rast se për çfarë duhen një diferencë prej 59 (pesëdhjetë e nëntë) punonjësish dhe nuk ka pasqyruar dhe bashkangjitur në dokumentat e tenderit.

Vëmë në dijeni autoritetin kontraktor se caktimi I numrit të përgjithshëm të punonjësve që nevojiten për realizimin e punimeve në objektin e prokurimit është rezultat analizës teknike të zërit të preventivit ku specifikohen orët e punës për fuqinë punëtore, të nevojshme për realizimin e një njesie volume, e shumëfishuar kjo me volumin total të parashikuar si dhe bazuar në orët e punës ditore deri në përfundimin e afatit të punimeve dhe si rezultat përfitohet numri i nevojshëm i fuqisë punëtore që nevojitet për realizimin e plotë të punimeve në përputhje me grafikun e

punimeve

Nisur nga sa pershkruam me siper kerkojme modifikimin e ketij kriteri dhe caktimin e nje numri punonjesish ne nume rjo me shume se 50 (pesedhete) .

**5. Kërkesë për ekspertizë të posaçme**

Po

Jo

*(Nëse po, specifikoni llojin e ekspertizës që kërkoni)*

---

**6. Kërkesë për përjashtim të zyrtarëve që do të merren me shqyrtimin e ankesës:**

jo

---

**7. Lista e informacionit konfidencial:**

jo

---

*Përcaktoni se cili informacion është konfidencial, nëse ka. Shpjegoni pse informacioni është ose një version i dokumenteve përkatëse me heqjen e pjesëve konfidenciale dhe një përmbledhje të përmbajtjes.*

***Kujdes: Ankimuesi duhet t'i bashkëlidhë ankimit, që do të paraqesë në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik***

---

Dërgojeni formularin e plotësuar të ankesës së prokurimit, të gjitha shtojcat e nevojshme dhe kopjet shtesë, pranë **Autoritetit/Enti Kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.**

Shënim: Ankimuesi duhet ta dërgojë njëkohësisht ankesën në autoritetin/entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit publik

**Nr. i faksit:**

**E-mail:**

llucashpkpeqin@gmail.com

**Nënshkrimi dhe vula e Ankuesit**

**Administratori/Përfaqësuesi i autorizuar**

Naim Lluca